



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22268141

Nr. 1592/5 Prot.

Tiranë, më 17.10. 2017

V E N D I M

Nr. 208, Datë 17/10/2017

*"Për pezullimin e procesit të verifikimit, lidhur me transferimin e përkohshëm të punonjësve ***** , ***** , ***** dhe ***** , personel i administratës doganore pjesë e shërbimit civil".*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të kërkesave të ardhura nga punonjësit ***** , ***** , ***** dhe ***** , përmes shkresave nr. 1408 prot., dt. 25.7.2017; nr. 1560 prot., dt. 24.8.2017; nr. 1592 prot., dt. 13.9.2017 dhe nr. 1609 prot., dt. 19.9.2017,

V ë r e j s e

Në zbatim të urdhrave të verifikimit nr. 1408/1 akti, dt. 28.7.2017; nr. 1560/1 akti, dt. 14.9.2017; nr. 1592/1 akti, dt. 14.9.2017 dhe nr. 1609/1 akti, dt. 20.9.2017, pas administrimit të informacionit që është dërguar pranë KMSHC nga punonjësit ***** , ***** , ***** dhe ***** , personel i administratës doganore pjesë e shërbimit civil, ka filluar inspektimi për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, gjatë procesit të transferimit të përkohshëm të tyre, në një pozicion tjetër të administratës doganore.

Pasi u shqyrtua paraprakisht përmbajtja e akteve të dëguara në mbështetje të problemeve të evidentuara në informacionet/ kërkesat e përmendura më sipër, lindën dyshime të arsyeshme në lidhje me respektimin e afateve të transferimit të përkohshëm, gjatë procesit të transferimit të përkohshëm të nëpunësve civilë ***** , ***** , ***** dhe ***** , e për këtë arsye filloi hetimi administrativ.

Më tej, me shkresat nr. 1408/3 akti, dt. 28.7.2017; nr. 1560/2 akti, dt. 14.9.2017; nr. 1592/2 akti, dt. 14.9.2017 dhe nr. 1609/2 akti, dt. 20.9.2017, iu kërkua institucionit, që të paraqiste sqarimet e tij lidhur me veprimet administrative objekt i këtij hetimi, përpara marrjes së vendimi përfundimtar nga Komisioneri.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresat nr. 17716/1 prot., dt. 7.8.2017; nr. 20974/1 prot., dt. 20.9.2017 dhe nr. 20975/1 prot., dt. 22.9.2017, "*Kthim përgjigje*", ka dërguar dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet administrative të kryera për transferimin e përkohshëm të punonjësve në fjalë, si dhe komentet përkatëse në këtë rast.

Në vijim të komunikimit me institucionin, me shkresën nr. 22559 prot., date 4.10.2017, me lëndë "*Informacion*", (regjistruar në protokollin e KMSHC me nr. 1665 prot., dt. 5.10.2017), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka sqaruar disa arsye objektive, të cilat kanë bërë të pamundur respektimin e afatit 6 mujor të transferimit të përkohshëm.

Më konkretisht, në këtë shkresë është argumentuar se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ende nuk ka mundur të finalizojë procesin e ristrukturimit në kuadër strukturës dhe organikës së re, të miratuar me vendimin nr. 9, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për personelin e administratës doganore"*", për shkak të prioritetit për zbatimin e Programit të ri të qeverisë, pasi institucioni ndodhet në fazën e testimit të Projektit pilot për vlerësimin qendror doganor, në ndihmë të biznesit dhe thjeshtimit të procedurave doganore.

Mbështetur në këto argumenta, institucioni informon Komisionerin se, kërkesat e punonjësve për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, në zbatim të kuadrit ligjor të shërbimit civil, janë në vëmendjen kryesore të njësisë së administrimit të burimeve njerëzore dhe po trajtohen e vlerësohen rast pas rasti.

Nga analiza e dokumentacionit i cili është vënë në dispozicion deri tani, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe nga përmbajtja e vendimit nr. 9, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për personelin e administratës doganore"*", Komisioneri konstaton faktin se, ky institucion ndodhet ende në kushtet e ristrukturimit. Ky proces ka filluar me aktin nr. 30052/1 prot., datë 18.01.2017, përmes të cilit urdhërohet zbatimi i aktit nënligjor të sipërcituar. Më tej, me urdhrin nr. 7, datë 19.1.2017, të Departamentit të Administratës Publike, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit i cili ka filluar menjëherë nga puna dhe është në procesin e zhvillimit të veprimtarive të nevojshme procedurale në lidhje me rastin në fjalë.

Në rrethanat si më sipër, ku institucioni sqaron se, kërkesat e punonjësve për kthimin në vendin e mëparshëm të punës po trajtohen dhe vlerësohen rast pas rasti, bashkë me procesin e sistemimit të kuadër të zbatimit të strukturës dhe organikës së re, komisioneri vlerëson se duhet të vendoset pezullimi i procesit të verifikimit të informacionit të nisur me urdhrat e verifikimit nr. 1408/1 Akti, dt. 28.7.2017; nr. 1560/1 Akti, dt. 14.9.2017; nr. 1592/1 Akti, dt. 14.9.2017 dhe nr. 1609/1 Akti, dt. 20.9.2017, deri në momentin e përfundimit të procesit të ristrukturimit të institucionit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në nenin 66 të ligjit nr. 44/2014, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të informacionit të nisur me urdhrat e verifikimit nr. 1408/1 akti, dt. 28.7.2017; nr. 1560/1 akti, dt. 14.9.2017; nr. 1592/1 akti, dt. 14.9.2017 dhe nr.1609/1 Akti, dt. 20.9.2017, deri në momentin e përfundimit të procesit të ristrukturimit dhe nxjerrjes së akteve përfundimtare të transferimit, apo të përfundimit të marrëdhënieve me shërbimin civil, nga njësia përgjegjëse.
2. Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të njoftojë me shkrim Komisionerin, për përfundimin e procesit të ristrukturimit, si dhe të dërgojë të gjitha aktet e kërkuara për realizimin e këtij procesi verifikimi.
3. Të bashkohen këto raste, me hetimin administrativ të pezulluar me vendimin nr. 80, datë 11.4.2017 të Komisionerit, *“Për pezullimin e procesit të verifikimit nisur me urdhrin nr.661 prot, datë 14.11.2016”*.
4. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA